



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

---

C-IV-15-0794

A M, Prishtinë

*Paditësi*

Kundër:

Agjencia Kosovare e Privatizimit, me seli në Prishtinë, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë

*E paditura*

**DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT** (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Mr.sc. Bajram Miftari, me datën 25.10.2022, mori këtë:

**AKTGJYKIM**

I. Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadija e paditëses B S dhe VËRTETOHEN vendimet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit - Autoritetit të Likuidimit PEJ055-0035 dhe PEJ055-0036, të datës 30.04.2015, si të drejta dhe të bazuara në ligj.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**Rrethanat procedurale të çështjes**

Me datën 19.05.2015, paditësja B S ka paraqitur padi pranë Dhomës së Posaçme, kundër të paditurës Agjencia Kosovare e Privatizimit (në vazhdim: AKP), me të cilën ka kërkuar rishikimin e vendimeve të Autoritetit të Likuidimit (në vazhdim: AL), PEJ055-0035 dhe PEJ055-0036, të datës 30.04.2015. Në padi, ndër të tjera është theksuar: AL e ka refuzuar kërkesat e parashtruesit për kompensimin e tri pagave të papaguara të vitit 1999, dhe për kompensimin e pagesës për shkurtim nga puna, për periudhën nga viti 1999 e deri në momentin e likuidimit të NSH-së. Pas parashtrimit të kërkesës pran AL-së, i njëjti organ në vitin 2013 ia ka dërguar një letër ku ka kërkuar ...

Me padi është propozuar që të ndryshohet vendimi i lëshuar nga AL dhe paditësit t'i njihet e drejta në pagat e papaguara.

Me datën 10.03.2022, e paditura ka paraqitur përgjigje në padi, ku ndër të tjera ka theksuar: Objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit të AL, respektivisht përputhshmëria e tij me Ligjin 04/L-034, për AKP-në. Me nenin 74.2 të atij ligji është përcaktuar se ankesat e dorëzuara në Dhomën e Posaçme kundër vendimeve të AL, duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034. Paditësi nuk ka sqaruar se cila dispozitë ligjore është shkelur. Më tutje, ka ngritur edhe prapësimin e parashkrimit të kërkesës, duke theksuar se me nenin 36.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në, është përcaktuar se kërkesat apo pretendimet e pas afatshme, sipas kufizimeve kohore të aplikueshme, do të refuzohen si të pa baza. Me përgjigje në padi është propozuar që të hedhet poshtë padia apo të refuzohet kërkesëpadia, si dhe të vërtetohet vendimi i lëshuar nga AL.

Me datën 11.10.2022, Dhoma e Posaçme ka lëshuar një Urdhër me shkrim me të cilin ka kërkuar nga paditësi që të parashtrij përgjigje në përgjigjen në padi dhe të ofroj të dhëna apo dokumente se kur i është shkëputë marrëdhënia e punës dhe me cilin akt apo dokument.

Me datën 21.10.2022, paditësi ka paraqitur përgjigje në përgjigje në padi, ku ndër të tjera ka theksuar: Marrëdhënia e punës i është shkëputur gjatë kohës së masave të dhunshme të instaluar nga pushteti serb në Kosovë, e që ishte në atë kohë një veprim diskriminues i ushtruar kundër tij. Rrjedhimisht, në atë kohë nuk ka mundur t'i realizoj të drejtat e tij në gjykatë e as në institucione et e tjera. Parashtrësës ia ka bashkëngjitur disa prova shtesë.

### **Gjendja faktike e konstatuar**

Me nenin 8.1 të LPK- së është përcaktuar: *“Se cilat fakte do t'i konsiderojë të provuara e cilat jo, vendosë vetë gjykata në bazë të çmuarjes me ndërgjegje, e të kujdesshme të provave, por edhe në bazë të rezultatit të gjithë procedimit. Gjykata me ndërgjegje dhe me kujdes e çmon ç' do provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku”*.

Me qëllim të vërtetimit të saktë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata iu është referuar fakteve të prezantuara nga palët në procedurë dhe provave të bashkëngjitura nga palët në procedurë.

Pala paditëse ka dorëzuar provat si në vijim: Vendimi i AL, PRN125-0399, i datës 05.09.2014; vendimi i datës 27.12.1990; vërtetimi i datës 14.01.1991; akti noterial i datës 18.11.2013 dhe librezat e punës së paditësit, që të gjitha në kopje. Pala e paditur nuk ka paraqitur asnjë provë.

Pala paditëse, në padi dhe në parashtrësën e datës 21.10.2022 (përgjigje në përgjigjen e të paditurës), ka prezantuar këtë gjendje të fakteve: Ka qenë punëtorë në Ndërmarrjen Shoqërore “BANKKOS”. Me vendimin e datës 27.12.1990, i ka pushuar marrëdhënia e punës në atë ndërmarrje. Vendimi në fjalë është marrë në kohën kur në Kosovë dhe në NSH-në ku punonte, ishin instaluar masat e dhunshme të pushtetit të atëhershëm serb. Nuk është ankuar në ndonjë institucion të atëhershëm kundër vendimit diskriminues që ishte nxjerrë kundër tij e as nuk ka kërkuar kompensimin e pagave pas shkëputjes së marrëdhënies së punës, pasi ka qenë kohë e masave të dhunshme dhe ka konsideruar se nuk ka pasur mundësi që të realizoj të drejtat e tij.

E paditura në vendimin e sajë të atakuar me padi dhe në mbrojtjen e bërë pran kësaj gjykate, është fokusuar në argumentimin se kërkesa për kompensimin e pagave të periudhës 1990-1999, është e parashkruar dhe se paditësi nuk ka qenë në marrëdhënie pune, gjatë kohës kur AKP-ja ka ushtruar autorizimit ligjore lidhur me NSH-në. Rrjedhimisht, nuk i ka komentuar as faktet e prezantuara nga pala paditëse.

Në vlerësimin e kësaj çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundimin se faktet vendimtare të prezantuara nga pala paditëse, janë jo kontestuese, madje edhe të mbështetura në provat që ka prezantuar.

### **Arsyetimi ligjor**

Procedura gjyqësore pran Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në vazhdim: Dhoma e Posaçme), është e rregulluar Ligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji nr. 06/L-086, i publikuar në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 12/27, Qershor 2019), si ligj special. Përveç kësaj, si ligj procedural i përgjithshëm zbatohet Ligji për Procedurën Kontestimore (Ligji nr. 03/L-006), me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme. Kjo çështje është definuar me Ligjin për Dhomën e Posaçme, neni 76, paragrafi 3, ku është theksuar, se *“në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”*.

Gjykata fillimisht ka shqyrtuar se a është e nevojshme mbajtja e seancës dëgjimore me palët në procedurë apo çështja mund të vendoset në bazë të materialeve në lëndë. Këtë çështje nuk e adreson Ligji për Dhomën e Posaçme si ligj special, por vetëm LPK si ligj procedural i përgjithshëm. Me LPK, neni 4, është përcaktuar se:

- *4.1, Gjykata vendos për kërkesëpadinë pas shqyrtimit të çështjes juridike në seancë të drejtpërdrejtë dhe publike.*
- *4.2, Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj.*

Një rast të tillë të përcaktuar me të njëjtin ligj ku mund të merret vendim meritor pa pasur nevojë që të mbahet seancë dëgjimore, e kemi të rregulluar me nenin 399 të LPK-së, ku është përcaktuar si në vijim:

- *399.1, Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.*
- *399.2, Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura.*

Po ashtu, me nenin 152 të LPK-së (aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes), është përcaktuar: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadiës, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”*.

Gjykata, pas shqyrtimit të dosjes së lëndës ka ardhur në përfundimin se nga faktet e treguara apo të prezantuara nga pala paditëse në padi, e që nuk janë kontestuar si të tilla as nga pala e paditur, nuk del themelësia e kërkesëpadiës. Përkundrazi, mbi bazën e të gjitha fakteve siç i ka prezantuar pala paditëse në padi dhe në parashtrësën e dt. 21.10.2022 (përgjigje në përgjigjen e të paditurës), rezulton se kërkesëpadija nuk është e bazuar.

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartë përmendura dhe në zbatim të dispozitave ligjore të cituara më sipër, gjykata ka ardhur në përfundimin se janë përmbushë kushtet ligjore për të nxjerrë vendim meritore (aktgjykim) në këtë fazë të procedurës shkresore dhe se seanca mbajtja e seancës dëgjimore në këtë rast, është e panevojshme.

Pas një procesi të vlerësimit ligjor të fakteve të prezantuara nga pala paditëse dhe shqyrtimit të të gjitha provave materiale të ofruara prej saj, gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadija nuk është e bazuar në ligj.

Fakti se paditësit i ka pushuar marrëdhënia e punës më 27.12.1990 dhe se kërkesën për kompensim pagash për periudhën 1990-1999 e ka paraqitur me datën 06.08.2014, respektivisht pas 24 vitesh që nga pushimi i marrëdhënies së punës, tregon se kërkesa e tij është parashkruar.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76), është shfuqizuar me Ligjin e Punës (Ligj nr. 03/L-212), i cili ka hyrë në fuqi më 01 nëntor 2010, e i cili në dispozitat e tij qartazi ka normuar shfuqizimin e të gjitha Ligjeve ekzistuese të Punës në Kosovë. Megjithatë, Ligji i Punës nuk ka paraparë parashkrim në lidhje me pagesat e të ardhurave. Prandaj, kjo gjykatë konsideron se duhet të aplikohet parashkrimi i përgjithshëm për detyrimet civile. Këto rregulla gjendeshin në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Ligj nr. 690, i datës 30 mars 1978), i cili ishte në fuqi deri më 19 dhjetor 2012, datë kjo kur ka hyrë në fuqi Ligji i ri për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077). Sipas nenit 372, paragrafi 1 të LMD-së (të vitit 1978), parashkrimi i kërkesave periodike siç janë të ardhurat - pagat, ishte tri (3) vjet. Edhe LMD i ri ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vitesh (neni 353, paragrafi 1). Nga dispozitat e lartcekura, gjykata vlerëson se parashkrimi si institut i së drejtës civile në përgjithësi dhe në veçanti afati 3 vjeçar i parashkrimit për kërkesat monetare, është ruajtur në të gjitha ligjet që kanë qenë të aplikuar në atë kohë, por edhe me ligjin që tani është në fuqi.

Nga zbatimi i dispozitave ligjore të lartpërmendura, rezulton se kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave që i takojnë periudhës 1990-1999, është parashkruar me kalimin e afatit prej 3 vitesh, respektivisht në fund të vitit 2002. Fakti se kërkesa për kompensim pagash është paraqitur më 06.08.2014, tregon se paditësi ka kërkuar kompensimin e pagave, lidhur me të cilat i është parashkruar kërkesa para se ai të aplikonte pran Autoritetit të Likuidimit. Paditësi nuk ka prezantuar ndonjë të dhënë apo informacion se ka pasur ndonjë ngjarje juridike në ndërkohë, që eventualisht do të kishte ndërprerë rrjedhën e afatit të parashkrimit.

Përveç asaj që është theksuar më sipër, fakti se paditësit i ka pushuar marrëdhënia e punës më 27.12.1990, tregon se paditësi nuk ka qenë në marrëdhënie pune pas asaj date, respektivisht e ka

humbur statusin e punëtorit. Prandaj, nuk ka bazë ligjore kërkesa për paga në vitet pasuese, sepse paga paraqet të ardhurat që i ndahen punëtorit, si rezultat i angazhimit të tij në procesin e punës. Paditësi ka pohuar më tutje se nuk e ka kundërshtuar vendimin mbi pushimin e marrëdhënies së punës, të vitit 1990, para organeve gjyqësore kompetente të asaj kohe apo në periudhën e pasluftës 1998/99, gjë që nënkupton se vendimi në fjalë me të cilin paditësit i ka pushuar marrëdhënia e punës, ka mbetur në fuqi dhe nuk është anuluar ndonjëherë. Prandaj, kërkesëpadia rezulton si e pabazuar edhe nën argumentin ligjor se kërkohen pagat për periudhën kur paditësi nuk ka qenë në marrëdhënie pune dhe nuk e ka pasur statusin e punëtorit.

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartë cekura dhe në dispozitat ligjore të cituara më sipër, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Shpenzimet gjyqësore**

Me Ligjin për Dhomën e Posaçme, neni 62, është përcaktuar se vetëm palës së suksesshme në procedurë (palës që e fiton gjykimin), i takon kompensimi i shpenzimeve gjyqësore. Nëse pala e suksesshme nuk i kërkon shpenzimet ose nëse ashtu vendos Dhoma e Posaçme, atëherë secila palë i bart shpenzimet e veta. Në këtë çështje kontestimore, asnjëra nga palët në procedurë nuk ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve procedurale. Andaj, gjykata ka vendosur që secila palë në procedurë të bartë shpenzimet e veta gjyqësore.

### **Udhëzimi juridik**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim pranë Dhomës së Posaçme, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të tij, e cila i drejtohet Kolegjit të Apelit pranë Dhomës së Posaçme, konform nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

**Gjyqtari,  
Mr.sc. Bajram Miftari**